R E L A C I O N

PËR

PROJEKTLIGJIN

"PËR MBROJTJEN E SHËNDETIT NGA PRODUKTET E DUHANIT DHE PRODUKTET E LIDHURA ME TO"

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky relacion shpjegon qëllimin, objektivat, nevojën dhe përmbajtjen e projektligjit "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit dhe produktet e lidhura me to", i cili synon modernizimin e kuadrit ligjor kombëtar për kontrollin e duhanit dhe përafrimin e tij me acquis të Bashkimit Evropian, duke ruajtur si objektiv themelor garantimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së shëndetit publik, veçanërisht të fëmijëve, të rinjve dhe personave vulnerabël.

Projektligji hartohet në një moment të rëndësishëm të procesit të anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Përafrimi i plotë i acquis në fushën e kontrollit të duhanit përbën një *benchmark* specifik për mbylljen e negociatave në Kapitullin 28 "Mbrojtja e konsumatorit dhe e shëndetit". Për rrjedhojë, miratimi dhe zbatimi efektiv i kuadrit të ri ligjor nuk lidhet vetëm me përmbushjen e detyrimeve të përafrimit formal, por edhe me demonstrimin e kapacitetit të vendit për të zbatuar në praktikë standardet e Bashkimit Evropian në këtë fushë.

Projektligji është pjesë e një pakete të plotë përafrimi, e cila përfshin 13 akte të acquis të Bashkimit Evropian në fushën e kontrollit të duhanit. Brenda kësaj pakete, projektligji shërben si akti bazë horizontal për transpozimin e Direktivës kuadër 2014/40/B[1] (në vijim referuar edhe si TPD2[2]), të ndryshuar, dhe të Direktivës 2003/33/KE[3], ndërsa kërkesat teknike dhe procedurale të akteve të tjera të paketës do të reflektohen, sipas rastit, në aktet nënligjore të parashikuara në projektligj dhe në aktet e tjera të posaçme që plotësojnë kuadrin rregullator.

Projektligji synon njëkohësisht të përditësojë kuadrin ekzistues kombëtar, i cili aktualisht mbështetet në ligjin nr. 9636, datë 6.11.2006, "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit", të ndryshuar. Zhvillimi i tregut, shfaqja e produkteve të reja të duhanit dhe nikotinës, format e reja të reklamimit dhe shitjes, si dhe evoluimi i standardeve të BE-së dhe

[1] Direktiva 2014/40 "Për përafrimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative të shteteve anëtare për prodhimin, paraqitjen dhe shitjen e duhanit dhe produkteve të lidhura me të, dhe për shfuqizimin e Direktivës 2001/37/KE";

[2] Tobacco Products Directive.

[3] "Për përafrimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative të shteteve anëtare për prodhimin, paraqitjen dhe shitjen e duhanit dhe produkteve të lidhura me të, dhe për shfuqizimin e Direktivës 2001/37/KE"

rekomandimeve ndërkombëtare, e bëjnë të nevojshëm një rregullim të ri, më të plotë dhe më koherent.

Objektivat kryesore të projektligjit janë:

- përafrimi i legjislacionit shqiptar me kërkesat e zbatueshme të Direktivës 2014/40/BE dhe përafrimi i plotë me Direktivën 2003/33/KE;
- krijimi i bazës ligjore për zbatimin e akteve të tjera të paketës prej 13 aktesh të acquis në fushën e kontrollit të duhanit;
- rritja e nivelit të mbrojtjes së shëndetit publik, me fokus të posaçëm te fëmijët, të rinjtë dhe personat vulnerabël;
- rregullimi më i plotë i paraqitjes, etiketimit, paketimit, vendosjes në treg, njoftimit, gjurmueshmërisë dhe elementeve të sigurisë të produkteve të duhanit dhe produkteve të lidhura me to;
- forcimi i masave për parandalimin e fillimit të përdorimit, kufizimin e aksesit të të miturve dhe mbrojtjen nga ekspozimi i pavullnetshëm ndaj tymit dhe aerosolëve;
- përshtatja e kuadrit ligjor me produktet dhe format e reja të konsumit, përfshirë cigaret elektronike, qeskat me nikotinë dhe produktet njëpërdorimshme me avullim;
- forcimi i kufizimeve për reklamimin, promovimin dhe sponsorizimin, përfshirë format e reja dhe të tërthorta të marketingut;
- krijimi i një sistemi më të qartë institucional për zbatimin, kontrollin, raportimin dhe bashkëpunimin ndërinstitucional;
- sigurimi i një tranzicioni të administrueshëm drejt kërkesave të reja, nëpërmjet afateve të diferencuara dhe zbatimit gradual të disa dispozitave.

Dhe së fundmi, por jo për nga rëndësia, në kuadër të procesit të negociatave, objektivi kryesor është përmbushja e piketës mbyllëse për kapitullin 28 të acquis - Mbrojtja e konsumtaorit dhe shëndetit, e kërkuar në Pozicionin Negociues të Bashkimit Europian për Grupkapitujt II "Tregu i brendshëm"[4] e cila kërkon shprehimisht që, për mbylljen e negociatave nën Kapitullin 28, një ndër kushtet është: *"Shqipëria ka arritur një nivel të avancuar të përafrimit me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe detyrimet ndërkombëtare në fushën e kontrollit të duhanit, si dhe zbatimin e plotë dhe të duhur të tyre."*

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji është në përputhje me objektivat politikë të mandatit qeverisës 2025 - 2029 lidhur me procesin e integrimit të Shqipërisë në BE dhe me përparimin në bisedimet e anëtarësimit. Konkretisht: Shtylla 1: Shqipëria Europiane, nënseksioni 1.1: Shqipëria vend

[4] EUROPEAN UNION COMMON POSITION, Cluster 2: Internal Market, date 11.04.2025, pg 26

anëtar i Bashkimit Europian, ku parashikon se një ndër objektivat specifikë është përparimi në procesin e negociatave të anëtarësimit duke përmbushur plotësisht kriteret e anëtarësimit dhe mbyllja e negociatave për të gjithë kapitujt në vitin 2027.

Detyrimi për të përafruar legjislacionin shqiptar me Kapitullin 28 të legjislacionit evropian buron edhe nga Neni 70 dhe 75 i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA). Këto dispozita detyrojnë Shqipërinë që teknikisht të sjellë legjislacionin e saj kombëtar në linjë me atë të BE-së, por gjithashtu të sigurojë që ai të zbatohet siç duhet.

Projektakti është gjithashtu i planifikuar në Pozicionin Negociues të Republikës së Shqipërisë për Grupkapitujt II "Tregu i Brendshëm", si edhe i parashikuar në Planin e Punës për adresimin e Piketave Mbyllëse për Kapitullin 28.

Projektligji është gjithashtu në përputhje me kuadrin strategjik kombëtar për zhvillimin, integrimin evropian dhe mbrojtjen e shëndetit publik. Në nivelin e planifikimit të përgjithshëm, ai lidhet me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022-2030 (SKZHIE), miratuar me vendimin nr. 88, datë 22.2.2023, të Këshillit të Ministrave, e cila përbën dokumentin kryesor strategjik afatgjatë të zhvillimit të vendit dhe ndërthur agjendën e zhvillimit të qëndrueshëm me procesin e integrimit në Bashkimin Evropian. Në këtë kuadër, përmirësimi i shëndetit të popullatës, reduktimi i sjelljeve me risk që ndikojnë në sëmundjet jo të transmetueshme dhe përafrimi i politikave kombëtare me standardet e Bashkimit Evropian përbëjnë drejtime të rëndësishme të politikave publike me të cilat projektligji lidhet drejtpërdrejt.

Në nivel sektorial, projektligji kontribuon në zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Shëndetësisë 2021-2030, e cila orienton politikat kombëtare drejt përmirësimit të shëndetit dhe mirëqenies së popullatës, parandalimit të sëmundjeve dhe reduktimit të faktorëve të rrezikut për sëmundjet jo të transmetueshme. Kontrolli i duhanit, parandalimi i fillimit të përdorimit të produkteve të duhanit dhe nikotinës, veçanërisht nga fëmijët dhe të rinjtë, si dhe mbrojtja nga ekspozimi ndaj tymit dhe aerosoleve, janë në përputhje me këtë orientim të politikës shëndetësore. Projektligji lidhet gjithashtu me dokumentet e planifikimit të integrimit evropian dhe me masat e parashikuara në kuadër të Kapitullit 28 "Mbrojtja e konsumatorit dhe e shëndetit", ku përafrimi i plotë i legjislacionit kombëtar me acquis të Bashkimit Evropian në fushën e kontrollit të duhanit përbën një detyrim të procesit të negociatave.

Një referencë themelore strategjike dhe ndërkombëtare për politikën kombëtare të kontrollit të duhanit është Konventa Kuadër e Organizatës Botërore të Shëndetësisë për Kontrollin e Duhanit (WHO FCTC). Shqipëria e ratifikoi Konventën më 26 prill 2006 dhe ajo hyri në fuqi për Shqipërinë më 25 korrik 2006. Konventa përcakton kuadrin e përgjithshëm ndërkombëtar për reduktimin e kërkesës dhe ofertës së produkteve të duhanit dhe kërkon një qasje gjithëpërfshirëse, ndërsektoriale dhe të qëndrueshme ndaj kontrollit të duhanit. Projektligji mbështet zbatimin e këtyre angazhimeve, krahas procesit të përafrimit me acquis të BE-së.

Me rëndësi të veçantë është edhe aderimi i fundit i Republikës së Shqipërisë në Protokollin për Eliminimin e Tregtisë së Paligjshme të Produkteve të Duhanit, në kuadër të WHO FCTC. Shqipëria depozitoi instrumentin e aderimit më 15 maj 2026 dhe Protokolli hyri në fuqi për Shqipërinë më 13 gusht 2026. Ky zhvillim përforcon më tej orientimin strategjik drejt një sistemi të integruar të kontrollit të duhanit, duke përfshirë kontrollin e zinxhirit të furnizimit, gjurmimin dhe gjurmueshmërinë, masat kundër tregtisë së paligjshme, bashkëpunimin ndërinstitucional dhe shkëmbimin ndërkombëtar të informacionit. Për rrjedhojë, dispozitat e projektligjit që lidhen me gjurmueshmërinë, elementet e sigurisë dhe mekanizmat institucionalë duhet të lexohen edhe në kontekstin e këtij angazhimi të ri ndërkombëtar të Shqipërisë.

Hartimi i këtij projektligji është parashikuar shprehimisht në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve për vitin 2026, miratuar me vendimin nr. 812, datë 30.12.2025, të Këshillit të Ministrave, pika 19, si "Amendimi i ligjit nr. 9636 'Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit' dhe akteve nënligjore përkatëse", i planifikuar për tremujorin e tretë (Q3) të vitit 2026. Programi Analitik e lidh shprehimisht këtë nismë me përmbushjen e angazhimeve dhe piketave mbyllëse për Kapitullin 28 në kuadër të procesit të integrimit evropian, dhe me sigurimin e përafrimit të plotë me acquis e Bashkimit Evropian për kontrollin e duhanit, përfshirë gjurmueshmërinë dhe elementet e sigurisë për produktet e duhanit.

Në tërësi, projektligji materializon në nivel legjislativ një ndërthurje të tre drejtimeve strategjike: mbrojtjen e shëndetit publik dhe parandalimin e sëmundjeve jo të transmetueshme; përmbushjen e detyrimeve të procesit të integrimit evropian dhe të benchmark-ut përkatës të Kapitullit 28; si dhe zbatimin e angazhimeve ndërkombëtare të Shqipërisë në kuadër të ËHO FCTC dhe Protokollit për Eliminimin e Tregtisë së Paligjshme të Produkteve të Duhanit.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Nevoja për një ligj të ri buron nga ndërthurja e tre faktorëve: detyrimi për përafrim me acquis të BE-së; nevoja për të adresuar zhvillimet e tregut dhe kategoritë e reja të produkteve; dhe nevoja për të rritur efektivitetin e politikave kombëtare të mbrojtjes së shëndetit nga duhani dhe nikotina.

Përmasat e problemit shëndetësor e bëjnë të nevojshme një ndërhyrje të tillë. Shqipëria bën pjesë në një rajon gjeografik (Evropa Lindore) me prevalencë tradicionalisht të lartë të duhanpirjes. Matjet e proporcionit të duhanpirësve në Shqipëri bazohen në studime periodike të standardizuara të kryera në grupe të ndryshme të popullatës. Të dhënat e disponueshme të kryera në dekadën e fundit, tregojnë se, pavarësisht një prirjeje afatgjatë në rënie të duhanpirjes tradicionale në popullatën e rritur, përdorimi i duhanit vijon të përbëjë një problem të rëndësishëm të shëndetit publik në Shqipëri dhe shfaq prirje të ndryshme sipas

gjinisë, moshës dhe llojit të produktit. Analiza e studimeve kombëtare të kryera gjatë dekadave të fundit tregon se prevalenca e duhanpirjes së përditshme te popullata e rritur ka rënë nga rreth 25% në vitin 2000 në më pak se 21% në vitin 2019, me një rënie më të qëndrueshme te meshkujt dhe në grupmoshat më të mëdha. Në të kundërt, te femrat nën 65 vjeç evidentohet një prirje e lehtë në rritje, ndërsa te fëmijët dhe adoleshentët të dhënat më të fundit tregojnë rritje të përdorimit të produkteve të duhanit dhe, në mënyrë veçanërisht të dukshme, të cigareve elektronike. Studimi GYTS 2020 ("Anketa Globale e Duhanit tek të Rinjtë/Global Youth Tobacco Survey") tregon se 9,3% e nxënësve 13-15 vjeç përdornin cigare elektronike, me diferenca të konsiderueshme gjinore (14,2% e djemve dhe 4,1% e vajzave). Nga ana tjetër, të dhënat e HBSC 2021-2022 (Studimi mbi Sjelljet Shëndetësore të Fëmijëve në Moshë Shkollore/Health Behaviour in School-aged Children) konfirmojnë se përdorimi i cigareve elektronike rritet ndjeshëm me moshën, duke arritur në rreth 20% te 15-vjeçarët, dhe në nivele edhe më të larta te djemtë. Këto zhvillime tregojnë se problematika e kontrollit të duhanit po zhvendoset gradualisht nga një fokus vetëm te produktet tradicionale drejt nevojës për të adresuar edhe produktet e reja të duhanit dhe nikotinës, veçanërisht në funksion të parandalimit të inicimit dhe varësisë në moshë të re.

Barra shëndetësore dhe sociale mbetet gjithashtu e konsiderueshme. Sipas vlerësimeve në studime të kryera, pirjes së duhanit i atribuohen mbi 4.000 vdekje në vit në Shqipëri (rreth 16% e vdekjeve totale, sipas Institutit të Shëndetit Publik/Burazeri 2020), ndërsa vlerësime më të fundit (Atlasi i Duhanit, 2025) e çojnë këtë përqindje deri në rreth 18%, kryesisht nëpërmjet sëmundjeve kardiovaskulare, disa llojeve të kancerit dhe sëmundjeve kronike të frymëmarrjes. Krahas kësaj barre shëndetësore, VNR-ja evidenton edhe një ndikim të rëndësishëm social dhe ekonomik: sipas studimit të Tobacconomics të referuar në të, shpenzimet direkte për duhan dhe shpenzimet shëndetësore të lidhura me pirjen shtyjnë rreth 13.000 familje, me rreth 60.000 anëtarë, përfshirë mbi 10.000 fëmijë, nën vijën kombëtare të varfërisë. Këto të dhëna, të marra së bashku, tregojnë se ndërhyrja rregullatore duhet të synojë jo vetëm vijimin e reduktimit të duhanpirjes tradicionale, por edhe parandalimin e inicimit te fëmijët dhe të rinjtë, adresimin e përdorimit në rritje të produkteve të reja dhe forcimin e mbrojtjes së popullatës nga pasojat shëndetësore, sociale dhe ekonomike të përdorimit të duhanit dhe nikotinës.

Këto të dhëna duhet të lexohen së bashku me zhvillimet e evidentuara në nivel të Bashkimit Evropian. Në Vlerësimin e kuadrit legjislativ të BE-së për kontrollin e duhanit, të publikuar më 2 prill 2026 (SWD(2026) 111 final[5]), Komisioni Evropian vlerëson se kuadri ekzistues ka kontribuar në uljen e duhanpirjes dhe të vdekjeve të lidhura me duhanin, por evidenton njëkohësisht sfida në rritje nga shfaqja dhe përdorimi i shpejtë i produkteve të reja të duhanit dhe nikotinës, veçanërisht ndër të rinjtë. Ky konstatim përforcon nevojën që masat

[5] EXECUTIVE SUMMARY OF THE EVALUATION of the Tobacco Products Directive (2014/40/EU), the Tobacco Advertising Directive (2003/33/EC) and other related tobacco control policies across the EU

kombëtare të mos kufizohen vetëm te produktet tradicionale, por të adresojnë edhe mënyrat e reja të konsumit, aksesit dhe promovimit.

Së pari, Direktiva 2014/40/BE ka sjellë një kuadër të detajuar për paraqitjen dhe shitjen e produkteve të duhanit dhe produkteve të lidhura me to, duke përfshirë paralajmërimet shëndetësore, kërkesat e paketimit, cigaret elektronike dhe enët rimbushëse, produktet bimore për tymosje, produktet e reja të duhanit, shitjet ndërkufitare në distancë, gjurmueshmërinë dhe elementet e sigurisë. Direktiva 2003/33/KE përcakton ndërkohë rregulla të harmonizuara për reklamimin dhe sponsorizimin e produkteve të duhanit. Projektligji i integron këto kërkesa në një kuadër të vetëm kombëtar.

Është vlerësuar gjithashtu nëse objektivat e ndërhyrjes mund të arriheshin nëpërmjet ndryshimeve të mëtejshme të ligjit ekzistues nr. 9636/2006. Ky ligj është ndryshuar disa herë që prej miratimit të tij, duke adresuar në mënyrë të njëpasnjëshme problematika të veçanta, por pa një ristrukturim të plotë të kuadrit sipas acquis të BE-së. VNR-ja evidenton se kjo qasje graduale dhe e fragmentuar ka krijuar një kuadër ku disa elemente janë të përafruara, ndërsa të tjera mbeten pjesërisht ose plotësisht të paadresuara. Duke marrë parasysh vëllimin dhe natyrën strukturore të ndërhyrjeve të nevojshme - përkufizimet e reja, kërkesat e paketimit dhe etiketimit, produktet e reja, sistemet e njoftimit dhe raportimit, gjurmueshmërinë dhe elementet e sigurisë, masat e reja kufizuese, si dhe riorganizimin e mekanizmave institucionalë - është vlerësuar se ndryshimi i mëtejshëm i ligjit ekzistues do ta bënte tekstin edhe më të fragmentuar dhe më të vështirë për t'u zbatuar. Për këtë arsye është zgjedhur miratimi i një ligji të ri, si instrumenti më i përshtatshëm për të krijuar një kuadër të unifikuar, koherent dhe të lexueshëm, duke shfuqizuar ligjin ekzistues dhe duke siguruar një bazë të qartë për paketën e re të akteve nënligjore.

Së dyti, projektligji reflekton faktin se tregu ka evoluar ndjeshëm nga koha e miratimit të ligjit ekzistues. Krahas produkteve tradicionale të duhanit, janë shfaqur dhe janë përhapur cigaret elektronike, produktet e duhanit të ngrohur, qeskat me nikotinë dhe produkte të tjera që emetojnë aerosol. Për disa prej këtyre kategorive acquis vendos kërkesa të harmonizuara; për të tjera ekziston hapësirë diskrecioni kombëtar ose një vakum rregullator. Për këtë arsye, projektligji kombinon transpozimin e kërkesave të detyrueshme me masa kombëtare të zgjedhura mbi bazën e objektivit të mbrojtjes së shëndetit publik.

Së treti, gjatë hartimit është vlerësuar edhe mundësia e reflektimit të elementeve të caktuara të dy rekomandimeve të BE-së që përbëjnë soft acquis: Rekomandimit të Këshillit të 3 dhjetorit 2024 për mjediset pa tym dhe aerosol, që zëvendëson rekomandimin e vitit 2009, dhe Rekomandimit të Këshillit të 2 dhjetorit 2002 për parandalimin e duhanpirjes dhe nismat për përmirësimin e kontrollit të duhanit (2003/54/KE). Duke qenë se një pjesë e masave të këtyre rekomandimeve janë të natyrës jo-legjislative, projektligji nuk synon transpozimin e tyre si të ishin akte detyruese. Megjithatë, janë reflektuar ato aspekte që, pas vlerësimit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, kontribuojnë drejtpërdrejt në objektivat specifike të mbrojtjes së shëndetit.

Në këtë drejtim, projektligji zgjeron fokusin nga mbrojtja vetëm ndaj tymit të duhanit drejt mbrojtjes nga ekspozimi i pavullnetshëm ndaj tymit dhe aerosolëve; përfshin shprehimisht mbrojtjen e fëmijëve, të rinjve dhe personave vulnerabël; forcon masat për parandalimin e fillimit të përdorimit dhe ndërprerjen e tij; parashikon masa për kufizimin e aksesit të personave nën 18 vjeç; dhe përdor një qasje më të gjerë për produktet që, edhe kur nuk përmbajnë duhan ose nikotinë, emetojnë tym ose aerosol në ato dispozita ku një zgjerim i tillë është i nevojshëm për mbrojtjen nga ekspozimi.

Projektligji rregullon gjithashtu disa çështje që nuk janë të harmonizuara nga TPD2, janë të rregulluara vetëm pjesërisht prej saj ose i lihen shprehimisht diskrecionit kombëtar. Përzgjedhja e masave është bërë pas një analize të opsioneve rregullatore dhe duke marrë në konsideratë situatën aktuale, objektivin e mbrojtjes së shëndetit, veçanërisht të të rinjve, zhvillimet e tregut dhe nevojën për zbatim efektiv.

Qasja për masa më të forta mbështetet edhe nga gjetjet e Komisionit Evropian në SWD(2026) 111 final. Vlerësimi i vitit 2026 konstaton se, pavarësisht rezultateve pozitive të kuadrit aktual të BE-së, zhvillimi i shpejtë i produkteve të reja të duhanit dhe nikotinës, përdorimi i tyre në rritje - veçanërisht nga të rinjtë - dhe format e reja të tregtimit dhe promovimit krijojnë boshllëqe dhe sfida që nuk adresohen plotësisht nga kuadri i hartuar fillimisht për një treg të dominuar nga produktet tradicionale. Në këtë kontekst, masat kombëtare kufizuese të parashikuara në projektligj synojnë të veprojnë në mënyrë parandaluese në ato fusha ku ekziston risk i shtuar për inicimin e përdorimit, varësinë nga nikotina ose shmangien e mekanizmave të kontrollit.

Ndër masat kombëtare të reflektuara në projektligj veçohen:

- Ruajtja e kufirit minimal 18 vjeç për shitjen, furnizimin ose dorëzimin e produkteve të duhanit dhe produkteve të lidhura me to, e shoqëruar me detyrimin për verifikimin e moshës kur ekziston dyshim i arsyeshëm;
- Rregullimi i qeskave me nikotinë, kategori që nuk mbulohet nga TPD2, duke ndaluar vendosjen në treg të qeskave që përmbajnë më shumë se 4 mg nikotinë;

Kufiri maksimal prej 4 mg nikotine per qese eshte percaktuar mbi bazen e parimit te kujdesit, rrezikut te varesise dhe praktikave rregullatore te ndjekura ne vende te tjera evropiane, duke pasur parasysh se qeskat me nikotine nuk jane aktualisht te harmonizuara nga TPD2. Qasjet kombetare variojne nga vendosja e kufijve sasiorë deri te ndalimi i plote: Letonia ka vendosur nje kufi maksimal prej 4 mg nikotine per qese, ndersa Finlanda ka perdorur historikisht pragun prej 4 mg per dallimin e produkteve te nikotines pa recete nga ato qe kerkonin recete. Nderkohe, disa shtete kane zgjedhur masa edhe me kufizuese, si Belgjika, e cila ka ndaluar vendosjen ne treg te qeskave me nikotine, dhe Franca, e cila ka ndaluar produkte te caktuara per perdorim oral qe permbajne nikotine. Ne kete kontekst, pragu prej 4 mg perfaqeson nje qasje te ndermjetme dhe proporcionale, qe kufizon ekspozimin ndaj dozave te larta te nikotines dhe rrezikun e varesise, vecanerisht tek te rinjte, pa kaluar ne ndalimin e plote te kesaj kategorie produktesh.

- Ndalimi i produkteve njëpërdorimshme me avullim është një tjetër rregullim që shkon përtej kërkesave minimale të Direktivës 2014/40/BE.

TPD2 nuk parashikon ndalimin e cigareve elektronike njëpërdorimshme dhe, për rrjedhojë, zgjedhja e masës mbetet në diskrecionin kombëtar. Gjatë vlerësimit të opsioneve rregullatore janë konsideruar tre alternativa: ndalimi i drejtpërdrejtë i shitjes; kufizimi indirekt përmes kërkesave të rrepta të riciklimit dhe depozitimit; ose lejimi i tyre me kufizime mbi aromat, fuqinë dhe kapacitetin. Duke vlerësuar njëkohësisht objektivin e mbrojtjes së shëndetit publik dhe pasojat mjedisore të kësaj kategorie produktesh, është zgjedhur opsioni i ndalimit të drejtpërdrejtë.

Nga këndvështrimi i shëndetit publik, produktet njëpërdorimshme me avullim paraqesin shqetësim të veçantë për shkak të aksesueshmërisë së tyre dhe tërheqjes që mund të ushtrojnë mbi të rinjtë, duke rritur rrezikun e inicimit të përdorimit të nikotinës dhe krijimit të varësisë në moshë të hershme. Ky shqetësim është reflektuar edhe në zhvillimet rregullatore në disa shtete anëtare: Belgjika i ka ndaluar këto produkte nga janari 2025, duke e arsyetuar masën si me mbrojtjen e shëndetit, veçanërisht të të rinjve, ashtu edhe me mbrojtjen e mjedisit; Franca ka ndjekur një qasje të ngjashme. Këto zhvillime tregojnë një orientim drejt masave më të forta për një kategori produktesh që është zgjeruar me shpejtësi dhe që nuk ishte në qendër të kuadrit rregullator kur u miratua TPD2.

Nga këndvështrimi mjedisor, karakteri njëpërdorimësh i këtyre produkteve gjeneron një fluks të veçantë mbetjesh që kombinon elemente plastike, komponentë elektronikë dhe bateri, duke e bërë grumbullimin, ndarjen dhe riciklimin më të vështirë. Analiza e opsioneve rregullatore e lidh këtë problematikë me kërkesat e legjislacionit për mbetjet e pajisjeve elektrike dhe elektronike. Në Shqipëri ekziston tashmë një kuadër për mbetjet e pajisjeve elektrike dhe elektronike dhe për përgjegjësinë e zgjeruar të prodhuesit; megjithatë, për një produkt të projektuar që të hidhet pas përdorimit, vetëm vendosja e kërkesave për riciklim do të linte të hapura si shqetësimet shëndetësore, ashtu edhe problemet e menaxhimit të mbetjeve. Për këtë arsye, ndalimi është vlerësuar si masa që i përgjigjet në mënyrë më të plotë të dy objektivave: reduktimit të aksesit dhe tërheqjes së produkteve të nikotinës për të rinjtë dhe parandalimit të krijimit të mbetjeve të panevojshme nga pajisje elektronike me përdorim të vetëm.

- Ndalimi i shitjes nëpërmjet disa kanaleve ose vendeve me risk të shtuar për aksesin e të miturve, përfshirë makinat shitëse automatike, vetëshërbimin, shitjen ambulante dhe shërbimin postar;
- Zgjerimi i mbrojtjes nga ekspozimi i pavullnetshëm përtej tymit tradicional të duhanit, duke përfshirë produkte që emetojnë tym ose aerosol dhe duke rregulluar përdorimin e tyre në mjediset e përcaktuara nga ligji;
- Forcimi i ndalimeve të reklamimit dhe promovimit, përfshirë reklamimin në pikat e shitjes, tabelat reklamuese, posterat, kinematë dhe format e tjera të promovimit, si dhe

mostrat falas, zbritjet promocionale, kuponët, dhuratat, programet e besnikërisë, konkurset dhe praktikat e ngjashme;

- Trajtimi i produkteve të lidhura me duhanin, për qëllime të caktuara të reklamimit, promovimit, mbrojtjes së të miturve dhe mbrojtjes nga ekspozimi, në mënyrë më të gjerë se minimumi i harmonizuar, kur kjo justifikohet nga objektivi i shëndetit publik.
- Ndalimi i shitjes në distancë, përfshirë shitjen online brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, është zgjedhur veçanërisht për të garantuar efektivitetin e ndalimit të shitjes personave nën 18 vjeç. Në kushtet aktuale nuk ekziston një sistem i unifikuar dhe efektiv që të garantojë verifikimin e besueshëm të moshës së blerësit gjatë porosisë dhe dorëzimit të produkteve të blera online. Për pasojë, lejimi i këtij kanali do të krijonte një rrezik të konsiderueshëm që produktet e duhanit dhe produktet e lidhura me to t'u shiteshin ose dorëzoheshin personave nën 18 vjeç, duke anashkaluar kontrollin e moshës që mund të ushtrohet në pikën fizike të shitjes. Duke pasur parasysh potencialin e produkteve të nikotinës për të krijuar varësi dhe rëndësinë e parandalimit të inicimit në moshë të re, është vlerësuar se, në kushtet aktuale institucionale dhe teknike, ndalimi i shitjes online është masa më e përshtatshme dhe më e zbatueshme për mbrojtjen e të miturve.

Edhe kjo zgjedhje është në përputhje me shqetësimet më të gjera të evidentuara në vlerësimin e Komisionit Evropian të vitit 2026, i cili e lidh efektivitetin e kuadrit të kontrollit të duhanit me aftësinë për t'iu përgjigjur kanaleve të reja të tregtimit dhe modeleve të konsumit që ndikojnë veçanërisht te të rinjtë. Ndalimi kombëtar nuk paraqitet si kërkesë e drejtpërdrejtë e TPD-së, por si zgjedhje rregullatore brenda hapësirës së lejuar për shtetet, e justifikuar nga kushtet konkrete të zbatimit në Shqipëri.

Projektligji nuk rregullon në mënyrë të plotë prodhimin e produkteve të duhanit dhe produkteve të lidhura me to. Aspektet që lidhen posaçërisht me prodhimin do të përafrohen nëpërmjet një ligji të posaçëm për prodhimin e duhanit, i cili është në proces hartimi nga ministria përgjegjëse për bujqësinë. Përjashtimisht, projektligji ruan ato kërkesa që, edhe kur lidhen me fazën e prodhimit, kanë ndikim të drejtpërdrejtë në mbrojtjen e shëndetit publik dhe janë të nevojshme për funksionimin e skemës së parashikuar prej tij.

Një element tjetër i rëndësishëm është zbatimi gradual. Projektligji parashikon një periudhë të përgjithshme prej gjashtë muajsh nga botimi deri në hyrjen në fuqi, afate për miratimin e akteve nënligjore dhe periudha të mëtejshme tranzitore për operatorët ekonomikë dhe për produkte të vendosura tashmë në treg. Kjo qasje synon t'u japë institucioneve dhe aktorëve ekonomikë kohën e nevojshme për përshtatjen e procedurave, sistemeve, paketimit, njoftimeve dhe mekanizmave të kontrollit, pa cenuar objektivin për zbatim të plotë të kuadrit të ri.

Në përpmbledhje, përparësitë e projektligjit dhe efektet e pritshme vlerësohen si më poshtë

<u>Përparësitë e projektligjit:</u>

Krijon një kuadër ligjor unik, të përditësuar dhe të harmonizuar me direktivat e BE-së, që zëvendëson ligjin ekzistues të vitit 2006;

Forcon mbrojtjen e fëmijëve, të rinjve dhe personave vulnerabël nëpërmjet kufizimeve më të rrepta për shitjen, reklamimin dhe ekspozimin;

Vendos një sistem modern gjurmueshmërie dhe elementesh sigurie (Kreu VI), në linjë me standardet ndërkombëtare kundër tregtisë së paligjshme dhe koherent me atë të BE-së;

Përcakton qartë kompetencat institucionale dhe forcon bashkëpunimin ndërinstitucional dhe atë me Komisionin Evropian dhe OBSH-në.

Efektet e pritshme:

Zbatimi i projektligjit pritet të sjellë uljen e prevalencës së përdorimit të produkteve të duhanit dhe produkteve të lidhura me to, veçanërisht tek të miturit dhe të rinjtë, uljen e ekspozimit të pavullnetshëm ndaj tymit dhe aerosolëve, rritjen e efektivitetit të luftës kundër tregtisë së paligjshme të duhanit, si dhe përafrimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor shqiptar me acquis e Bashkimit Evropian në fushën e shëndetit publik.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDËS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është në përputhje me nenet 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Ai është hartuar në përputhje me detyrimet e Republikës së Shqipërisë në kuadër të procesit të integrimit evropian dhe me angazhimin për përafrimin gradual të legjislacionit kombëtar me acquis të Bashkimit Evropian.

Projektligji ruan lidhjen me legjislacionin horizontal dhe sektorial në fuqi, ndër të cilët:

- Ligji nr. 9636, datë 6.11.2006, "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit", i ndryshuar (i cili shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij ligji, sipas nenit 44);
- Legjislacioni në fuqi për akcizat, në lidhje me përkufizimin e cigares, cigarillos dhe produkteve të tjera të duhanit;
- Legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, në funksion të dispozitave për sistemin e gjurmueshmërisë dhe konfidencialitetin (neni 36);
- Legjislacioni në fuqi për inspektimin, në funksion të kompetencave të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor (neni 34);
- Ligji nr. 9256, datë 8.7.2004, "Për ratifikimin e Konventës Kuadër të OBSH-së për Kontrollin e Duhanit".

Dispozitat institucionale synojnë të shmangin mbivendosjen e kompetencave dhe të sigurojnë bashkëpunimin ndërmjet autoritetit përgjegjës për shëndetësinë, strukturave inspektuese, autoriteteve doganore dhe tatimore, Policisë së Shtetit dhe institucioneve të tjera përkatëse.

Projektligji nuk cenon parimet dhe të drejtat e njohura nga Kushtetuta dhe legjislacioni në fuqi, dhe siguron proporcionalitetin e masave kufizuese dhe sanksionuese të parashikuara në të, në funksion të qëllimit legjitim të mbrojtjes së shëndetit publik.

Me hyrjen në fuqi të ligjit të ri shfuqizohet ligji nr. 9636, datë 6.11.2006, "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit", i ndryshuar. Për të garantuar vazhdimësinë normative, aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të ligjit ekzistues do të vazhdojnë të mbeten në fuqi deri në miratimin e akteve të reja, për aq sa nuk bien në kundërshtim me ligjin e ri.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS TË BASHKIMIT EVROPIAN

Projektligji përafron:

- pjesërisht Direktivën 2014/40/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 3 prill 2014, "Për përafrimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative të Shteteve Anëtare lidhur me prodhimin, paraqitjen dhe shitjen e produkteve të duhanit dhe produkteve të lidhura me to dhe për shfuqizimin e Direktivës 2001/37/KE", të ndryshuar, dhe

- plotësisht Direktivën 2003/33/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 26 maj 2003, lidhur me reklamimin dhe sponsorizimin e produkteve të duhanit.

Shkalla e pjesshme e përafrimit me Direktivën 2014/40/BE nuk buron nga një mosreflektim i kërkesave që i përkasin fushës materiale të këtij projektligji. Ajo lidhet kryesisht me ndarjen e zgjedhur të kuadrit kombëtar rregullator: aspektet e Direktivës që lidhen posaçërisht me prodhimin do të transpozohen në ligjin e posaçëm për prodhimin e duhanit, i cili po hartohet nga ministria përgjegjëse për bujqësinë. Tabela e përputhshmërisë evidenton shprehimisht dispozitat e Direktivës që do të përafrohen në këtë akt të posaçëm.

Brenda fushës së tij, projektligji transpozon kërkesat e TPD2 për etiketimin dhe paketimin, paralajmërimet shëndetësore, raportimin e përbërësve dhe emetimeve në masën e parashikuar, cigaret elektronike dhe enët rimbushëse, produktet bimore për tymosje, duhanin për përdorim oral, produktet e reja të duhanit, shitjet në distancë, gjurmueshmërinë dhe elementet e sigurisë, si dhe mekanizmat e bashkëpunimit, raportimit dhe masave kombëtare shtesë.

Direktiva 2003/33/KE është reflektuar plotësisht në dispozitat e projektligjit për reklamimin në shtyp dhe shërbimet e shoqërisë së informacionit, reklamimin dhe sponsorizimin radiofonik, sponsorizimin e ngjarjeve dhe shpërndarjen falas të produkteve. Projektligji ruan, njëkohësisht, masa kombëtare më të gjera në fushat ku acquis vendos vetëm një nivel minimal harmonizimi ose nuk e përjashton vendosjen e një niveli më të lartë mbrojtjeje.

Projektligji reflekton gjithashtu, në mënyrë të përzgjedhur dhe të përshtatur me kontekstin kombëtar, elemente të Rekomandimit të Këshillit të 3 dhjetorit 2024 për mjediset pa tym dhe aerosol dhe të Rekomandimit 2003/54/KE për parandalimin e duhanpirjes dhe nismat për përmirësimin e kontrollit të duhanit. Këto elemente nuk paraqiten si transpozim i

detyrueshëm, por si masa kombëtare të politikës shëndetësore që mbështesin objektivin e një niveli të lartë të mbrojtjes së shëndetit.

Përafrimi përmes këtij projektligji përbën një pjesë të paketës së plotë prej 13 aktesh të acquis në fushën e kontrollit të duhanit. Përmbushja e plotë e benchmark-ut përkatës të Kapitullit 28 do të vlerësohet në raport me të gjithë paketën ligjore dhe nënligjore, si dhe me kapacitetin për zbatimin efektiv të saj.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji përmban 47 nene, të organizuara në 11 krerë. Përmbajtja e tij, në mënyrë të përmbledhur, është si më poshtë:

KREU I - DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 - Objekti. Ky nen përcakton objektin e ligjit: rregullat e etiketimit, paketimit, gjurmueshmërisë dhe elementeve të sigurisë të produkteve të duhanit, ndalimin e duhanit oral, shitjen ndërkufitare në distancë, njoftimin e produkteve të reja, kufizimet për cigaret elektronike e produktet bimore për tymosje, reklamimin, organizimin institucional, masat kufizuese ndaj ekspozimit të pavullnetshëm dhe mbrojtjen e të miturve.

Neni 2 - Qëllimi. Ky nen përcakton qëllimin e ligjit: garantimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së shëndetit publik, veçanërisht të fëmijëve, të rinjve dhe personave vulnerabël, në përmbushje edhe të detyrimeve nga KKDKD dhe Protokolli kundër tregtisë së paligjshme.

Neni 3 - Fusha e zbatimit. Ky nen përcakton produktet e mbuluara nga ligji (duhan, cigare elektronike, produkte bimore për tymosje, produkte të reja duhani, qeska nikotine, produkte njëpërdorimshme avullimi dhe produkte të tjera që emetojnë tym ose aerosol) dhe raportin e ligjit me legjislacionin që rregullon prodhimin.

Neni 4 - Përkufizimet. Ky nen përmban terminologjinë bazë të ligjit, duke përkufizuar konceptet kryesore si aerosol, cigare elektronike, duhan pa tym, produkt i ri duhani, autoritet kompetent dhe elementet e tjera thelbësore për zbatimin e dispozitave të mëtejshme.

Neni 5 - Nivelet maksimale të emetimeve për katranin, nikotinën, monoksidin e karbonit dhe substanca të tjera. Ky nen vendos kufijtë maksimalë të lejuar për katranin (10 mg), nikotinën (1 mg) dhe monoksidin e karbonit (10 mg) për cigare, si dhe detyrimin e prodhuesve dhe importuesve për të njoftuar Ministrinë përpara vendosjes në treg të produkteve të reja ose të modifikuara.

Neni 6 - Metodat e matjes. Ky nen përcakton standardet ISO për matjen e katranit, nikotinës dhe monoksidit të karbonit, si dhe detyrimin që matjet të verifikohen nga laboratorë të miratuar e të pavarur nga industria e duhanit.

Neni 7 - Raportimi i përbërësve dhe emetimeve. Ky nen vendos detyrimin e prodhuesve dhe importuesve për t'i raportuar Ministrisë listën e përbërësve, sasitë, të dhënat

toksikologjike dhe nivelet e emetimeve për çdo markë e lloj produkti, si dhe detyrimin e Ministrisë për të publikuar këtë informacion duke ruajtur sekretet tregtare.

Neni 8 - Lista prioritare e substancave shtesë dhe detyrimet e zgjeruara për raportim. Ky nen krijon një listë prioritare, të miratuar me udhëzim të Ministrit, të substancave shtesë që kërkojnë studime të zgjeruara nga prodhuesit e cigareve dhe duhanit kaush/për t'u dredhur, lidhur me toksicitetin, varësinë dhe shijen karakterizuese që ato mund të krijojnë.

KREU II - PARALAJMËRIMET E DETYRUARA SHËNDETËSORE DHE ETIKETIMI I PRODUKTEVE TË DUHANIT

Neni 9 - Dispozitat e përgjithshme. Ky nen vendos rregullat e përgjithshme që çdo njësi paketimi dhe paketim i jashtëm duhet të mbajë paralajmërime shëndetësore në gjuhën shqipe, të pashlyeshme dhe plotësisht të dukshme, pa u fshehur nga elemente të tjera të paketimit.

Neni 10 - Paralajmërimet e përgjithshme dhe mesazhet informative mbi produktet e duhanit. Ky nen përcakton formulimin, madhësinë dhe vendosjen e paralajmërimit të përgjithshëm dhe të mesazhit informativ mbi shërbimet e ndërprerjes së duhanpirjes, që shfaqen në njësitë e paketimit të cigareve dhe të duhanit kaush/për t'u dredhur.

Neni 11 - Paralajmërimet e kombinuara shëndetësore. Ky nen rregullon paralajmërimet e kombinuara (tekst dhe fotografi), që mbulojnë 65% të sipërfaqeve kryesore të paketimit të cigareve dhe duhanit kaush/për t'u dredhur, dhe ngarkon KNMSHPD-në me miratimin e listës së mesazheve, bibliotekës së fotografive dhe kalendarit të alternimit vjetor.

Neni 12 - Etiketimi i produkteve të duhanit për tymosje, të tjera nga cigaret, duhani kaush/për t'u dredhur, duhani nargjile (shisha) dhe produktet e duhanit të ngrohur. Ky nen lejon Ministrin të përjashtojë disa produkte të tymosjes nga paralajmërimet e kombinuara, duke vendosur në vend të tyre një paralajmërim të përgjithshëm dhe një mesazh paralajmërues me shkrim, sipas përqindjeve dhe formatit të përcaktuar.

Neni 13 - Etiketimi i produkteve të duhanit pa tym. Ky nen vendos paralajmërimin e detyruar "Ky produkt duhani dëmton shëndetin tuaj dhe krijon varësi" mbi 30% të dy sipërfaqeve më të mëdha të paketimit të produkteve të duhanit pa tym.

Neni 14 - Paraqitja e produktit të duhanit. Ky nen ndalon elementet e paketimit që promovojnë produktin, sugjerojnë se është më pak i dëmshëm, i japin veti shëruese ose i ngjajnë ushqimit a kozmetikës, dhe ndalon shprehjet mashtruese si "e lehtë" apo "me përmbajtje të ulët katrani".

Neni 15 - Pamja dhe përmbajtja e njësive të paketimit. Ky nen përcakton formën kuboide të paketimit të cigareve, sasinë minimale prej 20 cigaresh apo 30 g duhani për njësi paketimi, si dhe kufizimet mbi hapjen dhe rimbylljen e paketimit.

KREU III - CIGARET ELEKTRONIKE DHE PRODUKTET BIMORE PËR TYMOSJE

Neni 16 - Kushtet e vendosjes në treg dhe njoftimi i cigareve elektronike. Ky nen kërkon që prodhuesit dhe importuesit e cigareve elektronike dhe enëve rimbushëse të njoftojnë Ministrinë 6 muaj përpara vendosjes në treg, duke dhënë informacion të plotë mbi përbërësit, emetimet, dozat e nikotinës dhe procesin e prodhimit.

Neni 17 - Kërkesat teknike dhe etiketimi i cigareve elektronike dhe enëve rimbushëse. Ky nen vendos kufizime teknike (vëllimi i lëngut deri 10 ml, përqendrimi maksimal i nikotinës 20 mg/ml, siguria ndaj hapjes nga fëmijët) dhe kërkesa etiketimi, përfshirë paralajmërimet për varësinë nga nikotina.

Neni 18 - Reklamimi, mbikëqyrja e tregut dhe raportimi për cigaret elektronike dhe enët rimbushëse. Ky nen ndalon reklamimin dhe sponsorizimin e cigareve elektronike në media, radio dhe shërbime audiovizive, vendos detyrime raportimi vjetor për prodhuesit dhe importuesit dhe rregullon masat e Ministrisë në rast rreziku serioz për shëndetin.

Neni 19 - Produktet bimore për tymosje. Ky nen vendos paralajmërimin "Pirja e këtij produkti dëmton shëndetin tuaj" mbi 30% të sipërfaqeve kryesore të paketimit të produkteve bimore për tymosje dhe ndalon elementet mashtruese të paraqitjes.

Neni 20 - Raportimi i përbërësve të produkteve bimore për tymosje. Ky nen kërkon që prodhuesit dhe importuesit t'i raportojnë Ministrisë përbërësit e produkteve bimore për tymosje përpara vendosjes në treg, me publikim të mëvonshëm duke ruajtur sekretet tregtare.

KREU IV - MASAT KUFIZUESE PËR PËRDORIMIN E PRODUKTEVE TË DUHANIT

Neni 21 - Mbrojtja e të Miturve nga aksesi në Produktet e Duhanit. Ky nen ndalon shitjen ose furnizimin e produkteve të duhanit dhe produkteve të lidhura, me ose pa nikotinë, personave nën moshën 18 vjeç.

Neni 22 - Duhani për përdorim oral, qeskat e nikotinës dhe produktet e ngjashme. Ky nen ndalon vendosjen në treg të duhanit për përdorim oral dhe rregullon kushtet e vendosjes në treg të qeskave me nikotinë dhe produkteve të ngjashme.

Neni 23 - Ndalimi i shitjes së produkteve të duhanit. Ky nen përcakton ndalimet dhe kufizimet mbi format e shitjes së produkteve të duhanit, përfshirë shpërndarjen falas dhe shitjen nëpërmjet makinave automatike të aksesueshme nga të miturit.

Neni 24 - Shitja në distancë e produkteve të duhanit. Ky nen rregullon shitjen ndërkufitare në distancë të produkteve të duhanit, duke kërkuar regjistrimin e njësive të shitjes dhe verifikimin e moshës së blerësit.

Neni 25 - Njoftimi i produkteve të reja të duhanit. Ky nen vendos detyrimin e njoftimit paraprak pranë Ministrisë përpara vendosjes në treg të çdo produkti të ri të duhanit, me tarifa proporcionale për shqyrtimin e njoftimit.

KREU V - MBROJTJA PREJ EKSPOZIMIT TË PAVULLNETSHËM NDAJ TYMIT TË DUHANIT DHE AEROSOLËVE

Neni 26 - Ndalimi i duhanpirjes dhe i përdorimit të produkteve që emetojnë tym ose aerosol. Ky nen ndalon pirjen e duhanit dhe përdorimin e produkteve që emetojnë tym ose aerosol në mjediset e punës, institucionet shëndetësore e arsimore, transportin publik, mjediset e mbyllura tregtare, si dhe në disa hapësira të jashtme (këndet e lojërave, zonat sportive, rrethina e institucioneve arsimore e shëndetësore brenda 10 metrash).

Neni 27 - Shenjat paralajmëruese. Ky nen vendos detyrimin e pronarëve dhe administratorëve të mjediseve të prekura për të vendosur shenja që ndalojnë duhanpirjen, sipas formatit të miratuar nga KNMSHPD-ja.

KREU VI - GJURMUESHMËRIA DHE SIGURIA

Neni 28 - Gjurmueshmëria. Ky nen krijon sistemin e gjurmueshmërisë së produkteve të duhanit, me shënim të identifikuesve unikë në nivel njësie dhe të grupuar, dhe ngarkon Këshillin e Ministrave me miratimin e standardeve teknike përkatëse.

Neni 29 - Elementet e sigurisë. Ky nen kërkon vendosjen e një elementi sigurie, të vështirë për t'u falsifikuar, mbi çdo njësi paketimi, sipas standardeve teknike të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU VII - REKLAMIMI, PROMOVIMI DHE SPONSORIZIMI

Neni 30 - Reklamimi në median e shkruar dhe në shërbimet e shoqërisë së informacionit. Ky nen ndalon reklamimin e produkteve të duhanit në shtyp, botime dhe shërbime të shoqërisë së informacionit, me përjashtim të botimeve profesionale të tregtisë.

Neni 31 - Reklamimi dhe sponsorizimi televiziv e radiofonik. Ky nen ndalon reklamimin dhe sponsorizimin e produkteve të duhanit në transmetimet televizive dhe radiofonike.

Neni 32 - Edukimi publik. Ky nen ngarkon autoritetet përgjegjëse me zhvillimin e fushatave të ndërgjegjësimit publik mbi dëmet e produkteve të duhanit.

Neni 33 - Ndalimi i sponsorizimit të ngjarjeve dhe formave të tjera të promovimit. Ky nen ndalon sponsorizimin e ngjarjeve dhe aktiviteteve me efekte ndërkufitare nga prodhuesit, importuesit ose shitësit e produkteve të duhanit.

KREU VIII - ORGANIZIMI I STRUKTURAVE TË MBROJTJES SË SHËNDETIT NGA PRODUKTET E DUHANIT

Neni 34 - Autoriteti kompetent. Ky nen përcakton Ministrinë si autoritet kompetent kryesor, të mbështetur nga Inspektorati Shtetëror Shëndetësor për kontrollin e zbatimit dhe nga Instituti i Shëndetit Publik për ndjekjen shkencore e teknike.

Neni 35 - Bashkëpunimi dhe zbatimi. Ky nen rregullon detyrimet e raportimit të prodhuesve dhe importuesve, kompetencat e Ministrisë për ndalimin e produkteve jokonformë, si dhe bashkëpunimin me Komisionin Evropian dhe Organizatën Botërore të Shëndetësisë.

Neni 36 - Siguria e të dhënave, konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave personale. Ky nen garanton trajtimin konfidencial të sekreteve tregtare dhe përpunimin e të dhënave personale në sistemin e gjurmueshmërisë në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

KREU IX - KOMITETI NDËRSEKTORIAL PËR MBROJTJEN E SHËNDETIT NGA PRODUKTET E DUHANIT DHE PRODUKTET E LIDHURA ME TO (KNMSHPD)

Neni 37 - Krijimi dhe përbërja e KNMSHPD-së. Ky nen krijon KNMSHPD-në pranë Ministrisë, me përfaqësues nga 15 institucione qendrore, dhe përcakton se sekretariati i saj ushtrohet nga struktura përkatëse e Ministrisë.

Neni 38 - Kompetencat e KNMSHPD-së. Ky nen i ngarkon KNMSHPD-së orientimin e politikave, monitorimin e luftës kundër tregtisë së paligjshme, përcaktimin e mesazheve paralajmëruese shëndetësore dhe raportimin vjetor pranë komisionit parlamentar përkatës.

Neni 39 - Organizimi dhe funksionimi i KNMSHPD-së. Ky nen ngarkon KNMSHPD-në vetë me miratimin e rregullores së brendshme për mënyrën e thirrjes së mbledhjeve, kuorumin, vendimmarrjen dhe mandatin e anëtarëve.

KREU X - SANKSIONET

Neni 40 - Sanksionet. Ky nen përcakton sistemin e kundërvajtjeve administrative, me gjoba të shkallëzuara sipas natyrës së shkeljes (nga 5.000 lekë për duhanpirësin individual deri në 5.000.000 lekë për shkeljet e etiketimit, paketimit e gjurmueshmërisë nga prodhuesi ose importuesi), masat e konfiskimit e asgjësimit, dhe procedurat e ankimit administrativ e gjyqësor.

KREU XI - DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 41 - Lëvizja e lirë dhe masat kombëtare shtesë. Ky nen ndalon kufizimin e vendosjes në treg të produkteve konforme, ndërkohë që lejon Shqipërinë të mbajë ose të vendosë kërkesa shtesë të justifikuara nga shëndeti publik, të njoftuara pranë Komisionit Evropian.

Neni 42 - Raportimi periodik dhe rishikimi. Ky nen vendos detyrimin e Ministrit për t'i paraqitur Këshillit të Ministrave raport vjetor mbi zbatimin e ligjit, deri më 30 qershor, dhe, pas anëtarësimit në BE, raportimin pranë Komisionit Evropian.

Neni 43 - Aktet nënligjore. Ky nen ngarkon Këshillin e Ministrave, brenda 9 muajve, dhe KNMSHPD-në, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi, me miratimin e akteve nënligjore për standardet e gjurmueshmërisë, elementin e sigurisë dhe format e njoftimeve të parashikuara në ligj.

Neni 44 - Shfuqizimet. Ky nen shfuqizon ligjin nr. 9636, datë 6.11.2006, "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit", i ndryshuar, duke lënë në fuqi aktet nënligjore ekzistuese deri në miratimin e akteve të reja.

Neni 45 - Dispozitat kalimtare. Ky nen jep afate kalimtare: 12 muaj për përshtatjen e prodhuesve dhe importuesve, 12 muaj për qarkullimin e stokut ekzistues, dhe shtyn zbatimin e nenit 25 (njoftimi i produkteve të reja) po me 12 muaj.

Neni 46 - Zbatimi i ligjit pas anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Ky nen parashikon që, me anëtarësimin e Shqipërisë në BE, ligji të vazhdojë si instrument kombëtar i transpozimit të Direktivave 2014/40/BE dhe 2003/33/KE, me detyrime njoftimi shtesë pranë Komisionit Evropian.

Neni 47 - Hyrja në fuqi. Ky nen përcakton se ligji hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Përgjegjësia kryesore për zbatimin dhe mbikëqyrjen e ligjit i ngarkohet ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, e cila ushtron funksionet e autoritetit kompetent dhe koordinohet me institucionet e tjera sipas fushës së përgjegjësisë.

Zbatimi i projektligjit kërkon bashkëpunim të qëndrueshëm ndërinstitucional, në veçanti ndërmjet ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor, Institutit të Shëndetit Publik, organeve doganore dhe tatimore, Policisë së Shtetit, Autoritetit të Mediave Audiovizive, institucioneve përgjegjëse për arsimin, rininë, ekonominë, turizmin, mjedisin dhe pushtetin vendor, si dhe strukturave të tjera të përfaqësuara në KNMSHPD.

Ministria përgjegjëse për politikat doganore dhe tatimore ngarkohet me detyra që lidhen me sistemin e gjurmueshmërisë dhe elementet e sigurisë së produkteve të duhanit, përfshirë masat për pajisjen e njësive të paketimit me identifikues unik dhe bashkëpropozimin e standardeve teknike përkatëse. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave verifikon praninë dhe vlefshmërinë e identifikuesit unik dhe të elementit të sigurisë në hyrje ose dalje të produkteve nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë.

Projektligji parashikon gjithashtu afate konkrete për miratimin e akteve nënligjore: aktet e Këshillit të Ministrave për çështjet e përcaktuara në nenin 43 miratohen brenda 9 muajve nga hyrja në fuqi, ndërsa udhëzimet dhe aktet e KNMSHPD-së të parashikuara në të njëjtin nen miratohen brenda 6 muajve. Këto afate lidhen drejtpërdrejt me qasjen e zbatimit gradual

dhe me nevojën për ngritjen e mekanizmave teknikë dhe administrativë përpara zbatimit të plotë të kërkesave të reja.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, përmes Grupit Ndërinstitucional të Punës, i ngritur me urdhër të Ministrit nr. ___, datë ___.___.2026, "Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projektligjit 'Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit dhe produktet e lidhura me to' dhe akteve nënligjore në zbatim të tij". Grupi i punës është përbërë nga përfaqësues të:

Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (koordinator),
Ministrisë së Financave, Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave,
Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit,
Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve,
Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor
Institutit të Shëndetit Publik,

Ky projektakt është hartuar me mbështetjen e projektit SANECA II "Mbështetje për negociatat e anëtarësimit në kapiotujt ekonomikë të acquis", i cili zbatohet nga GIZ dhe financohet nga Qeveria Gjermane.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji sjell efekte financiare për buxhetin e shtetit, të lidhura me ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve të nevojshme për zbatimin e kërkesave të reja, përfshirë kapacitetet e mbikëqyrjes dhe inspektimit, kapacitetet laboratorike dhe infrastrukturën teknike dhe të teknologjisë së informacionit. Sipas përllogaritjeve paraprake të kryera në kuadër të Vlerësimit të Ndikimit Rregullator, këto kosto vlerësohen paraprakisht si më poshtë:

Kostoja totale e llogaritur paraprakisht mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (në milionë ALL, çmimet aktuale, terma nominalë):

Kategoria e kostos (mln ALL)	Viti 1	Viti 2	Viti 3
Mbikëqyrja e tregut dhe zbatimi (MSHMS, me mbështetjen e ISHSH sipas Nenit 34.2)	20	20	20

Kapaciteti laboratorik/testimi (përbërës dhe emetimet)	90	20	20
Mbikëqyrja e gjurmueshmërisë (lëshimi ID, aksesi i të dhënave)	60	10	10
Paneli i pavarur këshillimor mbi aromat karakteristike	18	8	8
Sisteme IT raportimi (EU-CEG tip)	20	–	–
TOTAL / GJITHSEJ	208	58	58

Nevojat konkrete buxhetore dhe shpërndarja e tyre sipas institucioneve përgjegjëse do të përcaktohen në një fazë të dytë në përputhje me kërkesat dhe afatet e zbatimit të ligjit dhe të akteve nënligjore që do të dalin në zbatim të tij.

MINISTËR

Klodiana SPAHIU